REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 20.4.2021

Me datë 20.4.2021, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Në mbështetje të Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", ligjit nr.15/2016"Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive, mbledhja u zhvillua online. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Bledianë Nika, Nersada Mandija, Ardjana Ndreu, Diana Muriqi, Daniela Jakoja, Ardita Spahija, Age Martini, Sabina Danaj, Erion Metushi, Sead Çoçja, Sokol Zaimaj, Jona Leqejza, Sabahet Lishi, Dhurata Tyli, Donika Ndoja, Kristi Shllaku, Valbona Doniku, Arvit Osja, Luan Heta, Elson Çeliku, Hilmi Lakti, Gerald Hasaj, Hekuran Gjorreta, Besmir Vukaj, Anton Deda, Gjergj Sokoli, Ornela Leka, Andi Hallunaj, Luigj Palushi, Nadir Spahija, Jetmira Rraboshta, Lindita Nika.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Mars 2020"*

2. Pr/ Vendim *"Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit "Rikonstruksioni i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (ndërtim i ri godina me kontenier 1+1 dhe 2+1)"*

3. Pr/ Vendim *"Dhënie pëlqimi për dhënie me qira në favor të subjektit Restorant Pizzeri Italia, të një sipërfaqe prej 27 m2 nr.pasurie 4/254, ZK 8594, Vol 9, faqe 83, në pronësi të Bashkisë Shkodër"*

4. Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër"*

5. Diskutime jashtë rendit të ditës

1. Mbledhja vijon me një diskutimin për tu hequr nga rendi i ditës Pr/Vendim "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit "Rikonstruksioni i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (ndërtim i ri godina me kontenier 1+1 dhe 2+1)"
Në fjalën e saj këshilltarja Nersada Mandija argumentoj kërkesën për heqje nga rendi i ditës se gjykuj që nuk është akoma gati që komuniteti rom të vendoset në këto godina, pas i nuk është hartuar asnjë strategji se si do të administrohet kampi, nuk ka një plan evakuimi, kam vënë re se shumica prej tyre nuk janë trajtuar me plane zhvillimi duke mos u adresuar në zyrat e punës për të kërkuar punë.
Pas diskutimeve rendi i ditës u hodh në votim, bashkë me kërkesën për heqje nga rendi i ditës të pikës 2 dhe me 32 vota Pro, miratohet.

2. Mbledhja vijon me projektvendimin *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Mars 2020"*. Nuk ka diskutime.
Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

3.Mbledhja vijon me projektvendimin *"Dhënie pëlqimi për dhënie me qira në favor të subjektit Restorant Pizzeri Italia, të një sipërfaqe prej 27 m2 nr.pasurie 4/254, ZK 8594, Vol 9, faqe 83, në pronësi të Bashkisë Shkodër"*. Fjala i jepet Kryetares së Bashkisë e cila relaton sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë.
Fjala i jepet znj. Jona Leqejza e cila shprehet se jemi dakord për dhënie në shërbim të privatëve, për rritje punësimi, për cdo pronë publike që është e pa shfrytëzuar.
Fjala i jepet z.Besmir Vukaj, i cili shprehet se dokumentacioni që bashkëshoqëron këtë projektvendim është i rregullt dhe i ligjshëm, prandaj jemi Pro. Në emër të grupeve të këshilltarëve fjalën e merr znj.Nersada Mandija dhe z.Gjergj Sokoli të cilët shprehen Pro.
Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

4.Mbledhja vijon me projektvendimin *"Për një ndryshim në VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër"*.
Fjala i jepet Kryetares së Bashkisë e cila relaton sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë.

Fjala i jepet znj.Jona Leqejza, e cila shprehet se parimisht jemi dakord për kërkesën për alokim të programeve të strehimit. Sa i përket K.F.Vllaznia, është shqyrtu dhe marrë në

konsideratë. E vlerësojm pozitivisht akt-marrëveshjen me tatimet. Gjithashtu duhet me marr parasysh ngjarjet e ditëve të fundit ku asht kthy mrapsht procedura e ankandit. Prandaj propozojmë që në këtë rialokim kësaj radhe të kalojnë diku 12 milion e tetëqindmijë lek, të cilat shërbejnë për dy këste të marrëveshjes.
Së treti sa i përket propozimit për rialokim për rrugët, është e vërtëetë që janë rrugë problematike, përshëndesim nismën e komunitetin, por ne e kemi të qartë dhe administrata e ka të qartë, se sa është lista e kërkesave për rrugë, ndoshta dhe ma të rëndësishme. Prandaj duhet moralisht të ndjekim një rend kronologjik. Ky ze të mos alokohet dhe në mbledhjen tjetër i bëj thirrje kolegëve të diskutojm ku do alokohen paratë.
Më pas diskuton Kryetarja e Bashkisë si dhe këshilltarë të tjerë, ku në përfundim Kryetarja e Këshillit citon ndryshimet e propozuara të miratohet programi 10661 O2 A1 dhe programi 10661 O2 A4, siç janë.
Administrimi i KF Vllaznia programi P08130.O2.A3 të bëhet 12,790,758
PO4520. O2.A të mos kalojë.
Në emër të grupeve të këshilltarëve fjalën e merr znj.Nersada Mandija dhe z.Gjergj Sokoli të cilët shprehen Pro.
Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti me ndryshime hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

Mbledhja vijon në diskutimet jashtë rendit të ditës.
Pas diskutimeve jashtë rendit të ditës, nga ana e Kryetares së Këshillit mbledhja deklarohet e mbyllur
Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 20.4.2021. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio (DVD)
Procesverbali përmban 3 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar **KRYETARE**

Denis LESHA **Brisela KADIJA**